



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:134895

Datë: 29.06.2024

Numri i dokumentit: 05876705

KPPP.nr.1706/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Astraplan” sh.p.k., NRB: 70464863, me seli në Rr. “ Mehmet Gradica, H.5/6, Bregu i Diellit”, në Prishtinë, të cilin e përfaqëson Adelina Isufi, avokate nga Prishtina, kundër debitorit Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Arsimit dhe Shkencës, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 227/2020 të datës 22.09.2020 të Përmbartuesit Privat Ilir Mulhaxha nga Prishtina, jashtë seancës, me datë 28.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Arsimit dhe Shkencës, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 227/2020 të datës 22.09.2020 të Përmbartuesit Privat Ilir Mulhaxha.
- II. MBETET në fuqi Urdhri Përmbartimor P.nr. 227/2020 i datës 22.09.2020, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Ilir Mulhaxha.
- III. DETYROHET debitori që në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim të ia paguaj kreditorit shumë prej 208.00 € (dyqind e tetë euro) në afat prej 7 (shtatë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Astraplan” sh.p.k., ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr. 227/2020 të datës 22.09.2020, me të cilin ka lejuar

përmbartimin, në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturës nr. 08/2020 të datës 12.05.2020 dhe Faturës nr. 07/2020 të datës 12.05.2020, me të cilin është detyruar debitori që në emër të borxhit, të ia paguaj kreditorit shumën prej 63,722.10 €, me kamat ligjore prej 8%, nga data kur kredia është bërë e arritshme e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore në pajtim me UA-MD-së nr.06/2014, nën kërcënim të përmbartimit me dhunë.

Debitori përmes Avokaturës Shtetërore, në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbartimor, duke theksuar se punimet sipas kontratës së lidhur ndërmjet palëve nuk janë duke u realizuar siç parashihet me kontratë dhe se për faturat të cilat është iniciuar procedura përmbartimore e cila është pranuar nga menaxheri i projektit nuk është aprovuar nga udhëheqësi i divizionit për zbatimin e projekteve në MASH. Më tutje ka shtuar se pagesa e punëve shtesë është rekomanduar nga menaxheri i projektit, mirëpo këto pozicione nuk janë përfunduar sipas aneks kontratës dhe për këtë arsye kundërshtohet pagesa e tyre. Ka shtuar se debitori nuk mund të përmbush një faturë për të cilën nuk ka marrë shërbimin e kontraktuar dhe se këtë vonesë e ka shkaktuar vet kreditori me mos kryerjen e punimeve sipas projektit, i cili i ka shkaktuar dëm debitorit dhe se nuk ka asnjë bazë ligjore që të kërkoj pagesën e faturave për punët të cilat ende nuk i ka përfunduar. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të anulohet urdhri përmbartimor.

Kreditori, përmes të autorizuarës së tij, brenda afatit ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim, duke theksuar se lidhur me pretendimin e debitorit se punimet nuk janë kryer sipas kontratës e që janë pranuar nga Menaxheri i Projektit, por jo edhe nga Udhëheqësi i Divizionit për Zbatimin e Projekteve në MASH-të, nuk paraqet asnjë bazë ligjore meqenëse menaxheri i projektit i ka aprovuar të gjitha punët e kryera sipas situacionit, ku me datën 12.05.2020 ka paraqitur Situacionin III, ku janë përshkruar të gjitha punët e kryera nga kreditori, është nga z. Musa Shala dhe është konsideruar që janë kryer punimet në rregull dhe pa vërejtje, dhe për këtë shkak është lëshuar fatura Nr.07/2020 e cila është pranuar nga ana e debitorit dhe ka mbetur pa paguar shuma prej 48,760.70 €. Më tutje ka shtuar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit se nuk janë kryer punimet shtesë, pasi që me datën 15.11.2019 kreditori ka paraqitur te menaxheri i projektit situacionin për punët shtesë dhe në këtë situacion janë përshkruar të gjitha punët e kryera nga ana e kreditorit dhe se ka mbetur për pagesë shuma prej 14,961.40 € dhe se këtë situacion të punëve të kryera e ka nënshkruar menaxheri i projektit ku është konsideruar se është punuar në rregull dhe pa vërejtje dhe në bazë të kësaj është lëshuar edhe fatura Nr. 08/2020 e datës 12.05.2020 e cila është pranuar nga ana e debitorit. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet

prapësimi i debitorit si i pa themeltë, të mbetet në fuqi urdhri i lejimit P.nr.227/2020 i datës 22.09.2020, dhe të obligohet debitori që ti paguaj shpenzimet për përpilimin e përgjigjes në prapësim në shumë prej 208 € si dhe shpenzime të tjera procedurale.

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike lidhur me këtë çështje përmbartimore me Aktvendimin KPPP.nr.378/22 të datës 27.01.2023, e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit, si dhe ka lënë në fuqi urdhrin përmbartimor P.nr. 227/2020 të datës 22.09.2020 të përmbartuesit privat Ilir Mulhaxha.

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, me Aktvendimin K.Dh.Shk.II.570/23 të datës 18.09.2023, ka aprovuar si të themeltë ankesën e debitorit dhe ka prishur aktvendimin KPPP.nr.378/22 të datës 27.01.2023, të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike dhe e ka kthyer lëndën në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit të paraqitura në përgjigjen në prapësim, vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, dhe vërejtjeve të dhëna sipas aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbartim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara, si dhe janë të përshtatshme për përmbartim, bazuar në dispozitat e nenit 29 par.3 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*. Me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën

paragrafit 1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm – përkatësisht Faturën nr. 08/2020 të datës 12.05.2020 dhe Faturën nr. 07/2020 të datës 12.05.2020, fatura të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara punët të cilat janë kryer, sipas situacionit të punëve për projektin ndërtimi i sallës së sportit në Gurakoc – Istog, nr. prokurimit: 208 Udheheqësi-19-1705-5-2-1 dhe nr. prokurimit 208 Udheheqësi-19-9651-5-2-5, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Në rastin konkret rezulton se Fatura nr. 07/2020 në vlerë prej 48,760.70 € është lëshuar nga ana e kreditorit me datën 12.05.2020 dhe e njëjta është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt me datën 20.05.2020, e cila vërtetohet nga vula e pranimi dhe numri i protokollit nr. 805, ndërsa Fatura nr. 08/2020 në vlerë prej 14,961.40 €, është lëshuar nga ana e kreditorit me datën 12.05.2020 dhe e njëjta është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt me datën 20.05.2020, e cila vërtetohet nga vula e pranimi dhe numri i protokollit nr. 800.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat janë dorëzuar në kopje të vërtetuara, mbajnë vulën e pranimi të debitorit, si dhe nuk janë kontestuar asnjëherë nga debitori.

Gjykata morri parasysh udhëzimet e Gjykatës Komerciale Dhomat e Shkallës së Dytë sa i përket shqyrtimit të kohës së përmbushjes së detyrimit dhe gjeti se rastin konkret faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara për zbatimin e përbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, meqenëse faturat e lartcekura, janë bërë të arritshme pas kalimit të afatit 30 ditore nga data e lëshimit të tyre, përkatësisht me datën 12.06.2020.

Andaj bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës përmbarimore, gjykata ka vendosur në kuptim të dispozitave të nenit 463 dhe 453 të LPK-së, lidhur me nenin 17 dhe 13 të LPP-së, duke ia njohur shpenzimet e të autorizuarës së kreditorit për përpilimin e përgjigjes në prapësim në shumën prej 208.00 €, siç është e përcaktuar me rregulloren në fuqi për tarifat e avokatëve të datës 18.03.2017 të Odës së Avokatëve të Kosovës.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1706/23, datë 28.06.2024

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.